

20241642907

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 52 paragrafit (3) të Ligjit për Arsimin Fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

K A L E N D A R PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SHKOLLAVE FILLORE NË VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Neni 1

Me këtë kalendar përcaktohet organizimi i vitit shkollor në shkollat fillore konform njësive programore në vitin shkollor: gjysëmvjetori, format e tjera të veprimtarisë arsimore dhe pushimin e nxënësve për vitin shkollor 2024/2025.

Neni 2

Viti shkollor në shkollat fillore fillon më 1 shtator 2024 ndërsa përfundon më 31 gusht 2025.
Viti mësimor fillon më 2 shtator 2024 dhe përfundon më 10 qershor 2025.

Neni 3

Vitin mësimor e përbëjnë dy gjysëmvjetore - gjysëmvjetori I dhe II.
Gjysëmvjetori i parë fillon më 2 shtator 2024 dhe përfundon më 30 dhjetor 2024.
Gjysëmvjetori i dytë fillon më 20 janar 2025 dhe përfundon më 10 qershor 2025.

Neni 4

Gjatë vitit shkollor nxënësit shfrytëzojnë pushim dimëror dhe veror.
Pushimi dimëror fillon më 31 dhjetor 2024 dhe përfundon më 19 janar 2025.
Gjatë pushimit dimëror, punonjësit e shkollave nga data 2 janar 2025 deri më 10 janar 2025 shfrytëzojnë ditë jopune me pagesë.
Pushimi veror fillon më 11 qershor 2025 dhe mbaron më 31 gusht 2025.

Neni 5

Shkollat fillore nga data 11 qershor deri më 20 qershor 2025 organizojnë mësim plotësues, provime korigjuese dhe provime klasore, ndërsa nga data 18 gusht deri më 22 gusht 2025 organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera për të ndihmuar nxënësit që duhet t'i nënshtrohen provimeve korigjuese dhe provimeve klasore dhe t'i realizojnë ato.

Neni 6

Puna edukativo -arsimor për nxënësit organizohet gjatë gjithë javës së punës.

Neni 7

Në vitin shkollor 2024/2025 mësimi realizohet në 180 ditë mësimore.

Neni 8

Në ditën e shkollës organizohen ngjarje kulturore, sportive dhe të tjera.
Dita tradicionale e arsimimit për pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase shënohet me organizimin e manifestimeve kulturore dhe manifestime të tjera.

Dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët e bashkësive të cilët e ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditë mësimore kur zhvillohen programe të veçanta për manifestimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 9

Ditët e punës kur realizohen ekskursionet e nxënësve, dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditë mësimore kur zhvillohen programe të veçanta.

Për nxënësit që nuk ndjekin ekskursionet e nxënësve, shkolla organizon mësim të rregullt konform orarit të orëve mësimore.

Neni 10

Me ditën e fillimit të implementimit të këtij kalendari pushon së vlefshmi Kalendar për organizimin dhe punën e shkollave fillore në vitin shkollor 2023/2024 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 167/23).

Neni 11

Ky kalendar hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 shtatori 2024.

Nr. 18-7415/1
6.8.2024
Shkup

Ministër
i Arsimit dhe Shkencës,
Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.